



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK**



Nr. 1383 prot.

Tepelenë, më 04.08.2025

V E N D I M

Nr. 40, datë 31.07.2025

“PËR DETAJIMIN E OBJEKTIT “BLERJE MJETE TRANSPORTI PËR NEVOJAT E DREJTORISË SË SHËRBIMEVE PUBLIKE”, TË PARASHIKUAR NË ZËRIN E SHPENZIMEVE KAPITALE TË BUXHETIT TË VITIT 2025”

Këshilli i Bashkisë Tepelenë në mbledhjen e datës 31.07.2025, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë mbështetur në:

- Ligjin 139/2015 – datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”,
- Ligjin 57/2016, datë 02.06.2016 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr 9936 date 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit e buxhetor në Republikën e Shqipërisë”; neni 44
- Ligji 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 46
- Vendimin e Këshillit Bashkisë Nr. 72 datë 27.11.2024 “Për miratimin e Buxhetit të vitit 2025”, i ndryshuar

V E N D O S I :

1. Të miratohet detajimi i objektit “Blerje mjete transporti për nevojat e Drejtorisë së Shërbimeve Publike”, si më poshtë:
 - Një (1) kamionçinë vetëshkarkuese, me kapacitet transporti deri në 4 ton dhe kabinë me 4+1 vende;
 - Një (1) mjet tip fuoristradë “Pick-up”, me karroceri të hapur dhe kabinë 4+1 vende.
2. Detajimi i mësipërm do të përfshihet në zërin përkatës të shpenzimeve kapitale të buxhetit të vitit 2025, dhe fondet për realizimin e tij do të përdoren në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin financiar dhe prokurimin publik.

3. Ngarkohet Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik & Menaxhimit Financiar dhe Drejtoria Ligjore & Shërbimeve Organizative për zbatimin e këtij vendimi
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6 e ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucionit i Prefektit të Qarkut Gjirokastrë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Valbona ÇELA



Miratuar me 9 (nëntë) vota

Vota Pro 9 (nëntë) vota

Vota Kundër 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur më datë 04.08.2025

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

ARBEN GUMENI

